



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 13 qershor 2010
Nr. ref.: RK 23 /10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Rasti nr. KI 50/09

Parashtruesi i kërkesës

Afrim (Ajet) Haxha

kundër

Prokurorit Publik të Qarkut në Mitrovicë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës:

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Afrim (Ajet) Haxha, nga Komuna e Mitrovicës.

Pala kundërshtare:

2. Pala kundërshtare është Prokurori Publik i Qarkut në Mitrovicë.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pohon se me 22 dhe 23 mars 1996, forcat policore rrethuan shtëpinë e tij dhe u futën brenda me forcë. Ai thekson se disa oficerë policie, së bashku me persona të identifikuar, kanë vjedhur sende personale nga rezidenca e tij.

4. Parashtruesi i kërkesës i kërkon Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, që të shpallë këta njerëz fajtorë për këto krime dhe kërkon që të dënohen me ndëshkimin maksimal për krimet e supozuara, dhe, që familja e tij të kompensohet me shumën prej 8000 markave gjermane, plus kamatën nga data e krimit të supozuar.
5. Parashtruesi i kërkesës pohon se të gjitha autoritetet publike përkatëse, kanë dështuar të ndjekin penalisht autorët e supozuar për këto krime. Më 20 shkurt 2006, ai i kërkoi Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe Prokurorit Publik, të ndjekin penalisht këta individë për krimet e supozuara. Më 31 tetor 2008, ai i kërkoi, gjithashtu, Gjykatës Supreme të Kosovës që të ndërhyjë lidhur me çështjen e tij. Gjithashtu, i kërkoi dhe Ministrisë së Drejtësisë që të ndërhyjë dhe Gjykata e Qarkut të Mitrovicës të ndjekë penalisht këta individë.
6. Në një letër bashkangjitur kërkesës së tij në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës deklaroi se është ankuar kudo, por asnjëri nuk i kishte dhënë përgjigje. Ai theksoi se Gjykata Kushtetuese duhet të zgjidhë problemin e tij, ose ai do të marrë ligjin në duart e veta. Parashtruesi insiston se shumica e letrave dërguar institucioneve, nuk kishin dhënë asnjë përgjigje, prandaj, Gjykata ishte e vetmja mbështetje.
7. Parashtruesi i kërkesës pohon se e drejta e tij, për mbrojtje gjyqësore dhe përdorim të mjeteve efektive juridike, janë shkelur sipas Nenit 54 të Kushtetutës.
8. Nuk ka pasur asnjë përgjigje nga ndonjë autoritet gjyqësor ose publik në Kosovë, përveç një letre nga Ministria e Drejtësisë më 24 tetor 2008, në të cilën thuhet se Ministria e Drejtësisë nuk ishte kompetente për të vepruar mbi kërkesën e parashtruesit.

Baza ligjore

9. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tej - Kushtetuta); Neni 20 i Ligjit nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tej - Ligji), dhe Neni 54 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tej - Rregullorja).

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

10. Neni 6 i Kodit Penal të Përkohshëm të Kosovës autorizon një prokuror publik të përshtatshëm për të iniciuar procedurën penale, nëse ekziston dyshim i arsyeshëm se një person mund të ketë kryer vepër penale (shih Nenin 6 (3)). Dështimi nga ana e tyre për të filluar procedurën penale kundër çdo personi në bazë të ankesës së parashtruesit, është e arsyeshme të konkludojmë se prokurorët publik përkatës kanë arritur në përfundimin se nuk kanë pasur asnjë dyshim të arsyeshëm se një person mund të ketë kryer një krim, ose nuk ka pasur dëshmi të mjaftueshme për të vazhduar me ndjekje penale. Nëse prokurori publik vendos se nuk ka bazë për të iniciuar ose vazhduar me procedurën penale, roli i atij/asaj si prokuror mund të pretendohet nga pala e dëmtuar (shih Nenin 6 (4)). Nuk ekziston asnjë evidencë se parashtruesi, si palë e dëmtuar ka filluar ndonjë procedurë penale kundër ndonjë personi, lidhur me incidentin e datës 22 dhe 23 mars 1996.
11. Shihet se parashtruesi pretendon se të dyshuarit, në këtë rast kanë kryer krimin e vjedhjes së rëndë, duke shkelur Nenin 253 të Kodit Penal të Përkohshëm të Kosovës. Nëse dënohen, ndëshkimi maksimal që mund të vendoset për këtë krim është 5 (pesë) vjet burgim. Vjetërsia për këtë krim të kësaj natyre është deri në pesë vjet: shihni Nenin 90 të Kodit Penal të Përkohshëm të Kosovës. Prandaj, afati kohor

për ndjekje penale, duke filluar kundër çfarëdo të dyshuari, në këtë rast duhet të kishte skaduar me datën 21 ose 22 mars 2001 (pesë vjet nga dita kur është kryer krimi i supozuar). Prandaj, si çështje ligji, çfarëdo ndjekje penale tani, do të ishte e ndaluar sipas ligjit të vjetërsisë.

12. Neni 49 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, kërkon që kërkesa të parashtrohet në Gjykatën Kushtetuese brenda 4 (katër) muajve nga akti ose veprimi që ka krijuar një shkelje të të drejtave kushtetuese të parashtruesit. Në këtë rast, nëse ekzistonte një shkelje kushtetuese nga autoritetet përkatëse që të refuzonin ndjekjen penale, atëherë kjo shkelje ka ndodhur kur vjetërsia për këtë krim ka skaduar, me ose rreth 21 ose 22 mars 2001. Parashtruesi, fillimisht ka bërë përpjekje për të paraqitur kërkesën pranë kësaj Gjykate, në ose rreth datës 5 tetor 2009, përtej periudhës kohore të katër muajve, siç përcaktohet me ligj.
13. Me qëllim që të gjykojmë kërkesën e parashtruesit, Gjykata, fillimisht, ka nevojë të ekzaminojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në Kushtetutë. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili siguron se: "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkelje nga autoritete publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale që garantohen me Kushtetutë, por vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të parapara me Ligj".
14. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që të lejojë autoritetet në fjalë, duke përfshirë dhe gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar drejtësisht shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli është bazuar në supozimin se rendi ligjor i Kosovës, do të sigurojë një mjet lehtësimi efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit esencial të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, ECHR, *Selmouni v. France*, no. 25803/94, Vendim i 28 korrik 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të cekën në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Derisa çështja është cekur në substancë, ose në mënyrë implicite, rregulli i shterimit të mjeteve është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, ECHR, *Azinas v. Cyprus*, No. 56679/00, Vendim i datës 28 prill 2004).
15. Kjo Gjykatë, ka përdorur të njëjtin arsyetim kur mori vendimin me datën 27 janar 2010, në Lëndën Nr. KI.41/09 të AAB-RIINVEST University L.L.c, Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbi papranueshmërinë e kërkesës bazuar në mos shterimin e mjeteve juridike.
16. Parashtruesi nuk ka adresuar nëse ka bërë përpjekje për të kërkuar dëmshpërblim nga autorët e supozuar në procedurë civile. Ai, gjithashtu, nuk ka pohuar nëse është përjashtuar nga parashtrimi i një ankese të tillë. Prandaj, ai nuk ka përcaktuar nëse i ka shterur të gjitha mjetet juridike, siç nevojiten sipas Nenit 113, Paragrafit 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
17. Nuk shihet se parashtruesi i ka shterur të gjitha mjetet juridike që parashihen me ligj, as si prokuror privat, si palë e dëmtuar dhe as si ndërgjygjës civil në procedurë civile, për të kërkuar dëmshpërblim.
18. Neni 48 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës siguron se:

"Në Kërkesën e tij/saj, parashtruesi i kërkesës ka për detyrë të qartësoj saktësisht, se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik, të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

19. Parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar se cilat të drejta dhe liri mendon se i janë shkelur.

PËR KËTO ARSYE

20. Gjykata Kushtetuese, sipas Nenit 113(7) të Kushtetutës, Nenit 20 të Ligjit dhe Nenit 54 të Rregullores së Punës, në seancën e datës 13 qershor 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. TË HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve, Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Ministrit të Drejtësisë, si dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20(4) të Ligjit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Robert Carolan, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.